

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glogocit Labiriot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glogocit	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MEA-së	
Nga:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MPL Begolli	Datë: 25.01.2021
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	Nr.020-1019/6
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glogocit	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendim 12 Nr. 360/05-56366 për lirim nga qiraja joprofitabile, familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të Banimit Social në Bilokun I dhe II, në Drenasin III edhe për vitin 2021, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glogocit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.


Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Zivotne Sredine
Ministry of Economy and Environment



Për:	Goran Rakić, Ministër në MPL Trim Berisha, ud. Sekretar i Përgjithshëm në MPL
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Muharrem Nitaj, Ministër në detyrë i MEA Fatos Qerimi, Sekretar i Përgjithshëm i MEA
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lloji i aktit:	Vendimi 12 Nr.360/05-56366, për lirim nga qiraja joprofitabile familjet përfituese dhe shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II, në Drenasin III edhe për vitin 2021, miratuar nga KK Glllogoc.

I nderuar Ministër,
E nderuar Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Rregulloren (QRK) Nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullore (QRK) Nr. 06/2020 për Fushat

e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 12 Nr.360/05-56366, për lirim nga qiraja joprofitabile familjet përfutuese dhe shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II, në Drenasin III edhe për vitin 2021, miratuar nga KK Glllogoc.


I miratuar me datë: 28.12.2020

I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë:30.12.2020

I dërguar për shqyrtim në MEA, me datë: 31.12.2020

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson: Në nenin 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, parashihet "Kuvendi Komunal çdo vit aprovon shumën e qirasë vjetore për banesat me qira..." ndërsa në Nenin 10 paragrafi 1 të të njëjtit ligj thuhet: "Për familjet të cilat nuk kanë mundësi financiare të bëjnë pagesën e qirasë, shteti subvencionon deri në pesëdhjetë për qind (50%) të shumës së qirasë që duhet ta paguajë familja. Subvencionimi jepet vetëm pas verifikimit të gjendjes ekonomike të familjës, sipas nenit 12, të këtij ligji", ndërsa, në Nenin 12 paragrafi 1 përcaktohet: "Përfitimi nga programet e banimit bazohet në verifikimin e gjendjes ekonomike të familjes". Këtë çështje, po ashtu, e rregullojnë edhe dispozitat e nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr 18/2010 për përmbajtjen e Kontratës për banesën me qira joprofitabile.

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, konstatoi se Vendimi 12 Nr.360/05-56366, është bazuar edhe në Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.01/39 dhe Nr.01/42 për masat e përgjithshme dhe specifike për mbrojtje nga pandemia COVID-19, andaj, si e tillë Kuvendi Komunal i Glllogocit, duhet të marrë përgjegjësi në kompetencat e tyre për lirim nga qiraja joprofitabile për familjet përfutuese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II, në Drenasin III edhe për vitin 2021.





Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi I Komunës



¹² Nr. 360/01-56366 dt. 28.12 2020

Bazuar në nenin 11,12, dhe 40, të Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale Nr. 03/L-040, *nenit 34,pika 34.6*, të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 3 pika 1.1 , nenit 9, Ligjit Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimet Administrative, nenit 2, nenit 20 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, shpalljes së virusit COVID-19, si pandemi, Vendimit Nr. 01/07, Nr. 01/09, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik Nr. 01/39 të datës 01/11/2020, Vendimin Nr. 01/42, të dt. 11.11.2020 për masat e përgjithshme dhe specifike për mbrojtje nga pandemia COVID-19, Kuvendi i Komunës së Drenasit, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 28.12.2020,miratoi këtë:

V E N D I M

Për lirim nga qiraja joprofitabile, familjet përfituese të Shfrytëzimit të Përkohshëm të Banimit Social në Bllokun I dhe II, në Drenasin III edhe për vitin 2021.

Neni 1

Me këtë vendim, kërkohet lirimi nga obligimi i pagesës së qirasë joprofitabile mujore për periudhën 1 janar 2021 deri me 31 dhjetor 2021, të gjitha familjet përfituese të shfrytëzimit të Banimit të Përkohshëm Social në Bllokun I dhe II në Bllokun III, në Komunën e Drenasit.

Neni 2

Familjet e liruar nga qiraja joprofitabile për vitin fiskal 2021, janë të përcaktuara/përfshira në Vendimin e Kuvendit Komunal 12 Nr. 360-68569, të datës 29.11.2019.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit .



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj